


STATUTI
DHE
AKTI THEMELUES (KONTRATA)
E SHOQËRISË PRIVATE
" AD- STAR "



Në mbështetje të nenit 2, paragrafi 1, shkronja ç të ligjit nr 7512 datë 10.08.1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë dhe veprimtarive private të pavarura dhe privatizimin personat privatë nga rrethi i Përmetit Alfred Çoma dhe Robert Xhoxhi si themelues të shoqërisë së përbashkët, sot më 08.Maj.1994 duke pasur zotësinë ligjore për të vepruar :

U MORREN VESH DHE VEPRUAN (KONTRAKTUAN)

për sa vijon:

FORMIMI :

Artikulli 1

Formohet shoqëria private me emrin e shkurtuar "AD-STAR" e ortak ve themelues:

1. ALFRED ÇOMA ; i biri i Moisiut lindur në Këlcyrë më 19.07.1964 me profesion inxhinier ndërtimi me banim në qytetin e Përmetit, bllok "Toki Gjashta".

2. ROBERT XHOXHI; i biri i Apostolit lindur në Përmet më 20.08.195 me profesion ekonomist finance dhe banues në Përmet "Lagja 26 Janari nr 43.

VËND - QËNDRIMI

Artikulli 2

Vënd qëndrimi legal i shoqërisë private "AD-STAR" është aktualisht në qytetin e Këlcyrës në vëndin pranë furrave të gëlqeres në hyrje të qytetit. Shoqëria ka dhe një ambjent pune në qytetin e Përmetit në afërsi të dogës së Bankës Tregëtare në Përmet.

Shoqëria mund të hapë edhe vënd qëndrime të tjera operative, të dytë e filiale ,përfaqësi ose agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë, mbështetur në kriteret në fuqi dhe me miratimin e organeve përkatëse.

K O H Ë Z G J A T J A

- Artikulli 3 -

Kohë zgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë private "AD-STAR" është e pakufizuar, mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

O B J E K T I I V E P R I M T A R I S Ë

Artikulli 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë private "AD-STAR" është si më poshtë:

a. Veprimtari ndërtimore për objekte civile, industriale, bujqësore, ushtarake, banesa, zyra etj për individë vendas dhe të huaj ,për ndërmeje të ndryshme private e shtetërore, për shtetin, duke organizuar dhe konsultime e veprimtari projektuese, preventivuese, inzhinierike etj.

b. Prodhime materiale ndërtimi: betone, inerte, gëlqere, granit, çakël parafabrikate për banesa, për ndërtime civile, industriale, për rrugë, ujsjellësa, kanalizime etj.

c. Veprimtari ndërtimore për ujsjellësa, kanalizime, ndërtime rrugësh, mbajtje rrugësh e urash, ndërtime urash, trasesh, sistemime, rregullime, punime të tjera hidroteknike.

d. Bërje studimesh dhe hartim projektesh së bashku me preventiva për objekte civile, ndërtesa banimi, objekte industriale, rrugë, ujsjellësa, kanalizime etj.

e. Konsulencë tekniko ekonomike kryesisht në sferën e ndërtimeve, prodhimit e shitjes së material ndërtimit, punimeve hidroteknike.

f. Shitje materiale ndërtimi kryesisht gëlqere, inerte, granit etj.

g. Çdo aktivitet tjetër që veçan ose së bashku me ato të përmendur

në sipër do të konsiderohet i përshtatshëm e me leverdi për rritjen zhvillimin e shoqërisë private "AD-STAR".

Artikulli 5

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vëndqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrin ortakët e saj.

K A P I T A L I I S H O Q Ë R I S Ë

Artikulli 6

Kapitali fillestar i shoqërisë private "AD-STAR" është prej 100.000 lekësh, i formuar si vijom:

z. Alfred Çoma.....= 50.000 lekë ose 50%

z. Robert Xhoxhi.....= 50.000 " ose 50%

T O T A L I ; ; ; ; ; =100.000 " ose 100%

kuotat e kapitalit të çdo ortaku do të derdhen në llogarinë e shoqërisë së përbashkët private brënda afatit të caktuar nga ortakët.

Ortaku që nuk derdh në afatin e caktuar kuotën e tij të kapitalit mund të përjashtohet nga shoqëria.

Artikulli 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët e saj.

Artikulli 8

Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të gjitha të emërtuara të pandarshme. Çdo kuotë është baraz me 100.000 lekë dhe i takon e drejta e një vote.

Artikulli 9

Ortaku që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të tij të tërësisht ose pjesërisht, duhet të njoftojë më parë ortakët e tjerë të cilët kanë të drejtën e blerësit të parë.

Kjo e drejtë duhet ushtruar brënda tridhjetë ditëve nga data e

komunikimit.

Në rast të mos ushtrimit të të drejtës së blerjes së parë ortakut që do të shesë kuota të tij, duhet t'i komunikojë ortakut të ri dhe kushtet e shitjes.

Kushtet e shitjes ndaj të tretëve nuk mund të jenë më të favorshme në kushte të barabarta. Për kuotat e blera në këtë rast, ato në rradhë të parë duhet të ndahen sipas kuotave të kapitalit fillestar të tyre.

- O R G A N E T - D R E J T U E S E -

Artikulli 10

Organet drejtuese të shoqërisë janë : Asambleja e ortakëve dhe administratorët.

Fusha e veprimit, përvoja dhe mënyra e punës së organeve drejtuese, emërtimi dhe shkarkimi i antarëve dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e tyre rregullohen sipas këtij statuti të shoqërisë.

A S A M B L E J A

Artikulli 11

Asambleja e shoqërisë private "AD-STAR" përbëhet prej dy ortakëve të saj themelues: z. Alfred Çoma dhe z. Robert Xhoxhi.

Asambleja e shoqërisë është organ sovran i saj.

Themeluesit qeverisin veprimtarinë e shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private dhe mjetet e investuara në shoqëri.

Themeluesit e shoqërisë me vendim të posaçëm zgjedhin presidentin e shoqërisë dhe organet e tjera drejtuese.

Vendimet që merr asambleja e shoqërisë, sipas këtij statuti dhe ligjeve në fuqi të shtetit shqiptar janë të detyrueshme për të

gjithë ortakët e shoqërisë.

Asambleja zhvillon mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, në qendërën e saj legale ose jashtë saj në Shqipëri.

Artikulli 12

Çdo ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes në asamble mund të përfaqësohet në të edhe nga ndonjë ortak tjetër i shoqërisë, ose punonjës në shoqëri duke dhënë përfaqësim me shkrim.

Artikulli 13

Asambleja drejtohet nga personi i drejtuar prej saj, ose nga Presidenti i shoqërisë. Ortakët themelues të shoqërisë private "AD-STAR" kanë zgjedhur si president të saj z. Alfred Çoma. Presidenti zgjidhet çdo një vit me shumicë votash.

Artikulli 14

Vendimet e asamblesë janë të vlefshme nëse janë pranuar nga shumica e kapitali të tërë shoqërisë.

Artikulli 15

Emërimet për detyrat drejtuese bëhen me votëm të hapur ose sekret.

D R E J T I M I D H E A D M I N I S T R I M I

Artikulli 16

Shoqëria private "AD-STAR" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky akt themelues dhe statuti i saj si dhe legjisllacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me rregjistrimin e saj në gjykatë si person juridik, ndërsa ushtron aktivitetin ekonomik me rregjistrimin e saj në organin përkatës tatimor të rrethit Përmet. (Zyra e Tatime taksave Përmet).

Artikulli 17

Shoqëria ka vulën e saj të rrumbullaktë me përmbajtje "Shoqëria private ndërtimit AD-STAR " .

Artikulli 18

Shoqëria private "AD-STAR",vepron në rregullimin e pronës private dhe merr përsipër vehtes të drejtat dhe detyrimet. Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtëkontraktore brënda kapitalit të saj. Themeluesit bartin rrezikun për veprimtarinë e shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të kapitalit të investuara në rastin e krijimit të shoqërisë. Themeluesit nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetjake për detyrimet e shoqërisë, të cilën e kanë realizuar në veprimtarinë e tyre me persona të tretë. Vendimet që marrin ortakët e shoqërisë, në zbatim të ligjeve e të këtij statuti, janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Artikulli 19

Presidenti i shoqërisë dhe administratori i autorizuar prej tij, janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, pa asnjë lloj përjashtimi. Ato kanë mundësi të kryejnë të gjitha aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve të firmës. Ato kanë të drejtë midis të tjerave të blejnë dhe të këmbëjnë pasuri, që lidhen me shoqëri të tjera të ngritura ose që do të krijohen si brënda ashtu edhe jashtë Shqipërisë duke siguruar pjesëmarrje për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të përmendura në artikullin 4 të këtij statuti. Ato kryejnë çdo lloj veprimtarie pranë zyrave shtetërore dhe private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet ipotekore. Kryejnë pranë institucioneve bankare dhe financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa arkëtimi, qarkullimin e letrave me vlerë në tregun e parësë dhe të letrave me vlerë, kryejnë blerje shitje dhe çdo operacion lidhur me tituj aksionesh dhe obligacionesh të kuotuarra ose të pakotuarra në bursë kombëtare, titujt e shtetit apo të garantuara për llogari

të shoqërisë ose të tretëve.

Në këto raste administratorët e ngarkuar kanë për detyrë të njoftojnë dhe t'i japin llogarë presidentit të shoqërisë dhe sipas rastit edhe asamblesë.

M A R D H Ë N I E T E P U N Ë S

Artikulli 20

Presidenti i shoqërisë dhe asambleja caktojnë administratorët të cilëve në aktin e emërimit i u përcaktojnë detyrat dhe pagat. Po në kështu për puntorët e punësuar shoqëria marr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit e të sigurimeve shoqërore për to; ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë statutin e shoqërisë.

Artikulli 21

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e Legjislacionit shqiptar të punës.

Artikulli 22

Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe statutit për mos zbatimin e detyrave e për dëmet që i shkaktojnë shoqërisë. Mosmarrëveshjet e punonjësve të shoqërisë zgjidhen nga gjykata e rrethit Përmet.

Artikulli 23

Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria, nëse në kontratën e punës nuk parashikohet ndryshe.

Artikulli 24

Administratori nuk mund të marrë cilësinë e ortakut në shoqëri as edhe të ushtrojë një aktivitet konkurrues të çfarëdo lloji, për llogari të tij ose të tretëve, përveç atyre të autorizuara nga Presidenti i shoqërisë. Për çdo shkelje në këtë drejtim administratori largohet

- 8 -
nga puna dhe përgjegjësi për dëmet e shkaktuara.

S E K R E T I I P U N E S

Artikulli 25

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës të shoqërisë.

Detyra mbi ruajtjen e sekretit të punës nga të punësuarit në shoqëri vazhdon edhe mbas largimit të tyre nga kjo shoqëri.

P E R F A Q E S I M I I S H O Q E R I S E

Artikulli 26

Përfaqësimi i shoqërisë private "AD-STAR" i përket presidentit të saj dhe administratorit të autorizuar prej tij.

Presidenti dhe administratori kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë në organet gjyqësore e gjykime, të saktëojnë e të pushojnë avokatët për çështje në gjykim.

B I L A N C I D E T E A R D H U R A T

Artikulli 27

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabël të firmës me rezultatin ekonomik fitim, humbim bazuar në ligje e rregulla të mbajtjes së kontabilitetit nga njësitë ekonomike private përcaktuar prej organeve kompetente të sistemit fiskal.

Bilanci kontabël miratohet nga Presidenti dhe asambleja.

Me miratimin e bilancit kontabël vjetor, shoqëria vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme, si fondin e akumulimit, rezervës etj.

Artikulli 28

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe të

gimit të detyrimeve fiskale, i mbasin për përdorim ortakëve të firmës. Është e drejta e tyre të vendosin për përdorimin e tyre. Mënyra e ndarjes së fitimit do të bëhet proporcionalisht me futjen e kapitalit fillestar nga secili ortak.

Mbas miratimit të bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor, pjesa e fitimit neto mund të përdoret e gjitha për investime të reja, në rast se të gjithë ortakët bien dakort.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Artikulli 29

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë shkakut, si humbja e kapitalit të shoqërisë, pamundësi veprimtare ose vendim të asamblesë së shoqërisë. Në këtë rast pronarët e shoqërisë vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë, duke i u përcaktuar detyrat.

Likuidatorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë shoqërore përderisa t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në rradhë të parë detyrimet që i ka shoqëria personave të tre

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Artikulli 30

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut i referohet plotësisht nga asambleja e shoqërisë si dhe ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

Artikulli 31

Të gjitha kundërshtimet eventuale midis ortakëve të shoqërisë i nënshtrohen kompetencës së një kolegji prej tre arbitrash, nga të cilat secila palë në konflikt cakton një arbitër dhe i tretë caktohet nga dy të parët ose nga kryetari i gjykatës së rrethit Përmet.

Arbitrat kërkojnë zgjidhjen me mirkuptim dhe vendimet e tyre do të pranohen nga pjesëtarët në konflikt, si shprehje e vetë vullnetit të

tyre. Vendimet merren në vëndin e kohën e parashikuar nga asambleja e ortakëve.

Artikulli 32

Vendimet e kolegjit arbitrar mund të apelojnë vetëm nëse një nga palët kërkon arbitrazh të mëtejshëm pranë gjykatës së rrethit ku është depozituar ky statut vendimet e të cilit janë të paapelueshme, të detyrueshme për palët, me ekzekutim të menjëhershëm.

Artikulli 33


Ky statut dhe akt themelues përpilohen në disa kopje për t'u shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të formimit të shoqërisë "AD-STAR".

Statuti i hyn në fuqi ditën e nxjerrjes nga ortakët themelues të shoqërisë private "AD-STAR".

Akti themelues dhe statuti firmosen rregullisht nga të dy ortakët themelues të shoqërisë private "AD-STAR".

ORTAKËT THEMELUES :

/ ALFRED QOMA/



Përmet më 07.05.1994

/ ROBERT KLOXHI /

